

## **Z. SAIMIR SHYTI – KANCELAR PRANË GJYKATËS SË POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR.**

Z. Saimir Shyti, i lindur në Vlorë, më datë 01.05.1970, ka përfunduar fillimisht studimet e larta në Universitetin Politeknik të Tiranës, Dega Inxhinieri Mekanike (1994), e në vijim, është diplomuar Jurist pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër (2007). Në vitin 2011, ka përfunduar studimet “Master Niveli i Dytë në Shkenca Penale”, pranë Fakultetit të Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës.

Nga viti 2008 e në vijim, z. Shyti ka ushtruar detyrën e juristit, në pozicione të ndryshme pune, në disa institucione të rëndësishme të drejtësisë shqiptare, si: Ministria e Drejtësisë (2008-2009), Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës (2009-2011), e në vijim ka mbajtur pozicionin e Kancelarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda deri në vitin 2019. Nga dhjetori 2019 - aktualisht, ushtron detyrën e Kancelarit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar, mbështetur në Vendimin e KLGJ-së nr 286, datë 18.12.2019, “Për fillimin e funksionimit të gjykatave të posaçme për korruptionin dhe krimin e organizuar”.